

KUD: 371.12(496.51)  
323.282(496.51) "1913"

**Luan TETAJ**

**KRIMET E MALIT TË ZI NË LUGUN E BARANIT DHE THYERJA  
E FLAMURIT MALAZEZ NGA SELIM (AHMET) GËRVALLA NË  
VITIN 1913**

**Abstrakt:**

*Mali i Zi gjatë vitit 1913 ka kryer krime shumë të rënda në Lugun e Baranit. Ushtria dhe xhandarmëria malazeze në koordinim edhe me kishën ortodokse serbe bënë plane shumë të rënda për dëbimin e shqiptarëve nga trojet e tyre. Malazetët përpara se të fillojnë me procesion e konvertimit të popullatës shqiptare në fenë ortodokse, fillimisht e kryen procesin e çarmatimit të popullatës për t'u siguruar se procesi i konvertimit do realizohet me sukses. Përmes kërcënimeve të armëve ushtria malazeze në krye me Savë Llazareviqin e nxjerrin popullatën shqiptare në rrugë duke i drejtuar për t'u konvertuar në fenë ortodokse në Kishën e Gorozhdecit dhe në Patrikanën e Pejës. Familjet që e kundërshtonin urdhrin malazez pushkatoheshin në mënyrën më mizore nga ushtria dhe xhandarmeria malazeze. Për ta mbrojtur popullatën shqiptare të Lugut të Baranit që mos konvertohet në fenë ortodokse, Selim Gërvalla te Ura e Gurit në Pejë e kishte thyer flamurin malazez për të kundërshtuar më çdo kusht planet e pushtuesve malazezë.*

**Fjalë kyçe:**

*Mali i Zi, Serbia, Mbreti Nikolla, Savë Llazareviqi, Lugu i Baranit, krimet, Selim Gërvalla.*

Formimi i Aleancës Ballkanike në mes Serbisë, Malit të Zi, Bullgarisë dhe Greqisë u prit me shqetësime të mëdha nga krerët me të njohur të kryengritjeve shqiptare, dhe mbarë popullit shqiptar, meqenëse shqiptarët nuk u përfshin në aleancën ballkanike për të luftuar kundër sunduesve osmanë. Monarkitë ballkanike kishin hartuar plane ndaj popullit shqiptar. Serbia dhe Mali i Zi në bashkëpunim dhe mbështetje të plotë me kishën ortodokse serbe nën flamurin e nacionalizmit serbo-malazez filluan pushtimin e tokave

shqiptare. Si gjatë gjithë historisë së saj, edhe në ditët e sotme, Kisha Ortodokse Serbe i ka shërbyer dhe ka qenë pjesë e politikave nacionaliste serbo-malazeze. Shqiptarët u bënë shënjestër e nacionalizmit të egër serbo-malazez, duke gjetur mbështetje edhe nga vendet e tjera ballkanike.

Rrethanat politike, ekonomike dhe sociale në Kosovë gjatë vitit 1912 dhe 1913 qenë shumë të vështira pasi forcat serbo-malazeze filluan ekspeditën e tyre ushtarake kundër popullit shqiptar. Ushtria malazeze e mbështetur edhe nga aleatët e saj filloi sulmet ushtarake në drejtim të Shkodrës dhe në drejtim të sanxhakut të Rrafshit të Dukagjinit. Forcat e ushtrisë malazeze nën komandën e Radomir Veshoviqit, pasi e pushtuan Bjellopojën dhe Beranën më 8 dhe 9 nëntor 1912, marshuan në drejtim të Plavës dhe Gucisë. Ushtria malazeze hasi në rezistencë të fuqishme nga kryengritësit shqiptarë nën udhëheqjen e Bajram Currit, Hasan Ferrit dhe Riza Bej Kryziut. Kryengritësit shqiptarë u bënë qëndresë forcave malazeze deri më 17 nëntor.

Rezistenca e kryengritësve shqiptarë që e pamundur të vazhdonte, sepse ushtria malazeze numerikisht ishte më e madhe dhe posedonte armatimin më modern të kohës.<sup>1</sup> Ushtria malazeze pas pushtimit të Plavës dhe Gucisë ishte përgatitur fuqishëm për të pushtuar fillimisht Rugovën dhe pastaj Pejën. Malazetët hasen në rezistencë të fuqishme nga kryengritësit shqiptarë në Rugovë, por ishte e pamundur të ndalet marshimi i forcave malazeze. Ushtria malazeze pasi e pushtoi Rugovën, vërshoi në drejtim të Pejës dhe e pushtoi lehtësisht. Mbreti i Malit të Zi ishte lajmëruar zyrtarisht nga komandanti i ushtrisë malazeze në terren se: “*Pas pesë ditë luftimesh të përgjakshme në Qakorr, Rugovë, Mokën, Shtedim dhe Zhleb, ushtria jonë e mori Pejën dhe vendosi rend dhe qetësi*”.<sup>2</sup> Mali i Zi në territoret e pushtuara shqiptare vendosi administratën e ushtrisë dhe xhandarmerisë për të vepruar kundër atyre që e kundërshtonin pushtimin e Malit të Zi.

Patrikana e Pejës në koordinim të ngushtë bashkëpunonte me Metropolinë Ortodokse në Cetinë, dhe me ushtrinë malazeze që vepronte në terren për t’i çuar përpara projektet e tyre nacionaliste.<sup>3</sup> Mali i Zi kishte

<sup>1</sup> Tefik Geci, Bajram Curri, në Rilindjen Kombëtare Shqiptare, 1878-1912 (temë e magjistraturës), Prishtinë, 1980, f. 310; Isa Bicaj, *Marrëdhëniet shqiptaro-malazeze (1881-1914)*, Instituti i Historisë, Prishtinë, Prishtinë, 2003, f. 141; Isa Bicaj, Pushtimi i Pejës nga Mali i Zi në vitin 1912, (punim në dorëshkrim).

<sup>2</sup> Po aty, f. 142.

<sup>3</sup> Nikë Ukgjini, “Kërcënimi sllav-krahina e Rugovës në shtigjet historike më 1913, Rugova kryengritja dhe masakrat më 1918-1919”, Kumtesa të simpoziumit shkencor “100-vjetori i kryengritjes dhe i masakrave të Malit të Zi dhe të Serbisë në Shtupeq dhe në katunde të tjera të Rugovës, më 1919”, Instituti i Historisë, “Ali Hadri”, Prishtinë, Prishtinë, 2022, f.

hartuar planin për çarmatosjen dhe konvertimin me dhunë të shqiptarëve në fenë ortodokse në Krahinën e Rugovës, Pejës, Lugut të Baranit, Deçanit dhe Gjakovës. Një ndër arsytet që e shtynë Malin e Zi të ndërmer masa ekstreme për konvertimin e popullatës shqiptare në Lugun e Baranit dhe më gjerë, ishte për të bindur shtetet perëndimore se popullata e trevave në fjalë është me origjinë sllave.<sup>4</sup> Sipas pretendimeve malazeze populli shqiptar nën ndikimin dhe presionin e vazhdueshëm nga Perandoria Osmane ishte i detyruar të përqafonte fenë islame dhe pastaj të shqiptarizohen. Autoritetet malazeze ishin të bindura se shqiptarët do të kundërshtonin me çdo çmim konvertimin në fenë ortodokse dhe pastaj përmes formave gjenocidale ata synonin t'i realizonin planet e tyre në kurriz të shqiptarëve. Kjo ishte metoda më e mirë që përmes represionit, torturave, dhunës etj., popullsia shqiptare e Kosovës do të detyrohet të shpërngulej për Turqi dhe Shqipëri, dhe si rrjedhojë e kësaj politike numri i banorëve në Kosovë do të zvogëlohet dhe pastaj do vendosen kolonizatorët serbo-malazezë.<sup>5</sup>

Kur behët fjalë për arsimimin e popullit shqiptar në vendet e pushtuara nga Mali i Zi, këta të fundit vepruan edhe më dhunshëm se sa autoritetet osmane për lejimin e shkollave shqipe në gjuhën amtare. Mali i Zi i mbylli shkollat në qytetin e Pejës, Gjakovës dhe në Zllakuqan. Shkollat shqipe pasi u mbyllen nga autoritetet malazeze ato u zëvendësuan me shkolla serbe. Shqiptarët përveç që kundërshtuan mbylljen e shkollave shqipe, por edhe e bojkotuan mësimin në shkollat serbe, sepse kishin frikë se mund të shkombëtarizohen.<sup>6</sup> Gjatë kësaj kohe Austro-Hungaria ka mbështetur dhe përkrahura materialisht shkollat shqipe në Pejë,<sup>7</sup> por, nuk kishte fuqi të ndalonte mbylljen e tyre nga pushtuesit malazezë.

---

209.

<sup>4</sup> Duke iu referuar statistikave të bëra nga autoritetet osmane në vitin 1908-1909, tregojnë qartë se qyteti i Pejës kishte 72.5% popullsi shqiptare, ndërsa popullsi serbe kishte 19%. Ndërsa, duke iu referuar statistikave austro-hungareze të vitit 1916 tregojnë se në qytetin e Pejës ishin 83.1% shqiptarë dhe 19.9% serbë. Situata e ngjashme ishte edhe në qytetet e tjera të Kosovës.

<sup>5</sup> Isa Bicaj, *Marrëdhëniet shqiptaro-malazeze (1881-1914)*, Instituti i Historisë-Prishtinë, Prishtinë, 2003, f. 179.

<sup>6</sup> Nikollë Loka, "Lufta e pushtuesve serbë e malazezë ndaj shkollimit shqip në qarkun e Pejës në vitin 1912-1941", Kumtesa të simpoziumit shkencor "100-vjetori i kryengritjes dhe i masakrave të Malit të Zi dhe të Serbisë në Shtupeq dhe në katunde të tjera të Rugovës, më 1919", Instituti i Historisë, Ali Hadri, Prishtinë, Prishtinë, 2022, f. 236; Zef Mark Harapi, *Ditt e Trishtimit në N'Pejë e nder rrethe 1912-1913*, (Redaktor Dom Nikë Ukgjini), Dukagjini, Pejë, 2004, f. 104.

<sup>7</sup> Fehari Ramadani, *Kontributi i Austro-Hungarisë për zhvillimin e arsimit dhe të kulturës shqiptare, 1900-1912*, Arbëria Design, Tetovë, 2010, f. 109.

Gjatë vitit 1912-1913 autoritetet serbo-malazeze insistonin që fëmijët shqiptarë të vijonin mësimin në gjuhën serbe. “*Hapja e shkollave tona është shumë e nevojshme sepse këtu gjenerata e re do të mësonte gjuhën serbe dhe në atë mënyrë shumë shpejt, përveç masave të tjera, masat e shqiptarëve (arnaute) do të krijojnë ndjenjën serbe dhe do të ndjeheshin si serbë*”.<sup>8</sup> Po ashtu plan-programi mësimor i nxënësve shqiptarë duhej të ndërrohej që mos të jetë i njëjtë me nxënësit serbo-malazezë. “*Por, duhet të reduktohet vetëm në gjuhën serbe, në historinë serbe dhe në muzikën (këngën) serbe*”.<sup>9</sup> Autoritete malazeze kishin hartuar plane për asimilimin dhe shkombëtarizimin e shqiptarëve, dhe njëra ndër metodat më të mira dhe më efikase për të arritur qëllimin e tyre ishte mbyllja e shkollave në gjuhën shqipe. Atyre u pengonte edhe mbajtja e mësimin në gjuhën shqipe edhe në objektet e kultit,<sup>10</sup> prandaj morën masa të rrepta dhe kontrolluan çdo gjë për mos lejimin e mësimin në gjuhës shqipe.

Mbreti i Malit të Zi, Nikolla, kishte nxjerr urdhrin për trevat e pushtuara në Rrafshin e Dukagjinit se të gjithë banorët e fshatrave pa përjashtim duhej të konvertoheshin në fenë ortodokse se përndryshe do të dënoheshin shumë rënd. Për të zbatuar urdhrin e Mbretit Nikolla, ishte caktuar Savë Llazareviqi i njohur në popull me emrin Savë Batara,<sup>11</sup> i cili ishte komandant i xhandarmerisë në komunën e Pejës. Ai u bënte thirrje banorëve të Pejës, Llugut të Baranit dhe më gjerë së urdhri i Mbretit Nikollë duhej të zbatohet që të gjithë të kthehen në fenë e moçme, ku sipas tij këtë shembull e kishte ndjekur edhe Bullgaria ndër vendet që i kishte pushtuar. Ju

<sup>8</sup> Bajram Shatri, *Arsimi fillor në Kosovë në shekullin XX, sfida, dëshmi, fakte I*, Shtëpia Botuese: Libri Shkollor, Prishtinë, 206. f. 34.

<sup>9</sup> Po aty.

<sup>10</sup> Nikollë Loka, “Lufta e pushtuesve serbë e malazezë ndaj shkollimit shqip në qarkun e Pejës në vitin 1912-1941”..., f. 236; Zef Mark Harapi, *Ditt e Trishtimit në N’Pejë e nder rrethet 1912-1913*..., f. 104.

<sup>11</sup> Savë Llazareviqi i njohur më nofkën Batara, u lind në vitin 1849. Savë Llazareviqi ishte oficer malazez, pjesëmarrës në luftërat e viteve 1876-1878, si dhe në luftërat e viteve 1912-1918. Nga viti 1912 deri në vitin 1916 ishte emëruar komandant i xhandarmerisë ushtarake serbo-malazeze në pjesët e pushtuara malazeze në Rrafshin e Dukagjinit, anëtarët e së cilës njiheshin si burra me krahë, për shkak të shenjave që mbanin në kapelat e tyre, ku paraqitet një shqiponjë me krahë hapur. Ai u shqua për masakrat e kryera gjatë vitit 1913 kundër popullit shqiptar në Rugovë, Pejë, Lugu i Baranit, Deçan dhe Gjakovë. Sava vdiq me vëllain e tij Vuçetin në vitin 1943, duke u mbrojtur nga komunistët në shtëpinë e tyre (kulla e Lazarevicit) në Lipovë të Epërme afër Kolashinit. Pasi iu mbarua municioni, ata hodhën në erë veten me një granatë dore në moshën 93-vjeçare. Sava, padyshim që ishte njeri ndër oficerët malazezë më famëkeq dhe më kriminel që kishte shkelur ndonjëherë në mbarë trevat shqiptare. Ai ka kryer krime shumë të rënda kundër popullit shqiptar të Kosovës.

jeni një komb prandaj duhej të jeni të një feje. Sava iu thoshte banorëve të kësaj ane se padyshim herët a po vonë ju do ta ndërroni fenë.

Pushtuesit malazezë e dinin se shqiptarët arrinin të mbroheshin nga çdo lloji plani që vihej në kundërshtim me interesat e tyre kombëtare. Prandaj, pushtuesit për qëllimet e veta filluan aksionin për mbledhjen e armëve i cili u shoqërua edhe me vrasje masive.<sup>12</sup> Deri në fillim të muajit mars të vitit 1913 në rrethin e Pejës u mblodhën 9 325 pushkë, e gjatë kësaj kohe edhe në Gjakovë u mblodhën 1 777 pushkë.<sup>13</sup> Autoritetet malazeze përdorën metoda të ndryshme për çarmatimin e popullsisë në Rrafshin e Dukagjinit dhe veçanërisht në Lugun e Baranit, u zbatua plani i marrjes së njerëzve peng, ndërsa nga malazezët u vlerësua si mënyra më efikase për çarmatimin e popullatës. U morën kategori të ndryshme të elitës si bajraktarë, krerë, agallar, kryepleq fshati, tregtarë etj.<sup>14</sup>

Në dokumentin e lëshuar nga Ministria e Punëve të Brendshme e Malit të Zi, numër 553, 5 shkurt 1913 Cetinë, thuhet se kohën kur armët janë mbledh më së shumti dhe kur dukej që shumë vise do t'i nënshtroheshin pushtetit malazez në kuptimin e plotë, lartmadhëria e tij Mbreti, menjëherë kishte lëshuar urdhër që të shtyhej mbledhja e armëve deri më 25 janar të këtij viti. Kjo sepse duhej t'u epej kohë viseve që ende nuk i kishin dorëzuar armët. Pas dhënies së këtij urdhri nga mbreti, erdhën zëra që shqiptarët katolikë të shqetësuar, përgatiteshin të sulmonin Gjakovën. Autoritetet serbe lusnin që t'u liroheshin dy kodra për t'u mbrojtur më mirë dhe njëkohësisht protestonin përse nuk ishin mbledhur armët kur ata i kanë mbledhur ato edhe nga serbët në mënyrë të vënies sa më të shpejtë nën mbikëqyrjen e elementeve antishtetërore. Edhe pse kishte kaluar afati i caktuar nga urdhrit i mbretit, përsëri kishte filluar mbledhja e armëve në të gjitha trevat e pushtuara. Duke pasur parasysh çka do të thotë t'i kesh të çarmatosura viset të cilat kurrë nuk e kanë njohur pushtetin e askujt, sikur që edhe, mbledhja e armëve ishte shumë e vështirë kur mu në fqinjësi të atyre elementeve paraqitej një Shqipëri kombëtare rimokatolike, mos u bënë favore atyre, të cilët tashmë njëherë i kanë përdorur armët kundër pushtetit të tij dhe të cilët nuk do ta konsiderojnë si hir por si dobësi të shtetit tonë.<sup>15</sup>

<sup>12</sup> Zekeria Cana, *Socialdemokracia serbe dhe çështja shqiptare, 1903-1914*, Prishtinë, 1986, f. 147.

<sup>13</sup> Zekria Cana, "Kthimi i shqiptarëve me dhunë në fenë ortodokse më 1912-1913 (Dokumente)", *Dituria islame* Nr. 63, Prishtinë, 1994, f. 25.

<sup>14</sup> Zekeria Cana, *Gjenocidi i Malit të Zi mbin popullin shqiptar, 1912-1913 (Dokumente)*, Prishtinë, 1996, f. 37.

<sup>15</sup> Arkivi i Institutit të Historisë-Prishtinë, fondi: Državni Arhiv Cerne Gore Cetinje, DVCG, Ministarstvo Unutrašnjin Dvela Upravno Odelsnijem, MUDUO, (1912-1914).

Njoftimet e ushtrisë dhe autoriteteve malazeze nga terreni e informojnë Mbretin Nikolla, se popullsia e Lugut të Baranit nuk është mësuar të respektojë dhe njohë pushtimin, dhe nuk kishte frikë nga pushtimet pa marrë parasysh masat ndëshkuese. Për të shtypur këtë popullsi që nuk iu nënshtrohej urdhrave nuk ishte aspak e lehtë, por në terren ushtria malazeze përdori masa të rrepta represive të cilat me shumë kujdes duhej të kryheshin në mënyrë taktike. Sipas informacioneve që kemi marr nga terreni, një numër i madh i banorëve nga Lugu i Baranit qenë fshehur nëpër bjeshkë për kryerjen e krimeve, të cilët gjatë pranverës arritën të mobilizohen dhe të krijojnë trazira. Duke e njohur tashmë karakterin dhe mosbindjen e shqiptarëve në Lugun e Baranit ushtria malazeze kishte frikë nga një kryengritje e mundshme.

Ushtria malazeze për të ndaluar revoltën e mundshme nga popullsia vendase, filloi në mënyrë shumë rigorozë ekspeditën për mbledhjen e armëve nëpër fshatrat e Lugut të Baranit. Para se të fillojë aksioni i mbledhjes së armëve, autoritetet malazeze për ta pasur më të lehtë mbledhjen e armëve në terren, filluan të përdorin autoritetin e familjeve me ndikim në Lugun e Baranit. Padyshim së njëra ndër familjet me autoritet më të madh në Lugun e Baranit dhe më gjerë ishte familja e Selim Gërvallës nga fshati Kryshec. Por, Selim Gërvalla<sup>16</sup> jo zyrtarisht ishte informuar përmes kanaleve të ndryshme për planin e autoriteteve malazeze dhe në rrethin familjar dhe më gjerë e kishte kundërshtuar në mënyrë kategorike një mundësi të tillë pa marrë parasysh masat ndëshkuese që mund të merren ndaj familjes dhe rrethit të tij. Për ta mbrojtur popullatën e Lugut të Baranit, Selim Gërvalla përveç bashkëfshatarëve në fshatin Kryshec, brenda mundësive i informoi edhe banorët e fshatrave të tjera për aksionin e mbledhjeve të armëve nga autoritetet malazeze.<sup>17</sup> Gjatë asaj kohe mundësitë e informimit dhe lëvizjet e njerëzve nëpër fshatra ishin shumë të vështira pas hyrjes së ushtrisë malazeze. Çdo lëvizje e tyre mund të ishte vrojtuar nga autoritete malazeze dhe pasojat ishin të mëdha.

Autoritetet malazeze ishin të pakënaqura me gjendjen e krijuar në terren, dhe për të shpejtuar procesin e mbledhjes së armëve dhe për të

<sup>16</sup> Selim Gërvalla u lind në vitin 1868 në fshatin Kryshec të komunës së Pejës. U rrit dhe u edukua në një familje me tradita të larta kombëtare. Selim Gërvalla ishte njëri ndër personalitetet më të shquara që e kundërshtoi fuqishëm ndërrimin e fesë në Lugun e Baranit dhe më gjerë. Selim Gërvalla kishte lenë trashëgimtarët, djemtë: Rexhepin, Demushin dhe vajzat Ryvën dhe Ajshen.

<sup>17</sup> *Agjencia Shtetërore e Arkivave të Kosovës*, Fondi personal Muharrem Gërvalla nr. 704, shënime për konvertimin e popullsisë shqiptare në fenë ortodokse në Lugun e Baranit në vitin 1913.

vendosur në kontroll çdo gjë në fshatrat e Lugut të Baranit, dërguan një brigadë nën komandën e gjeneralit Camoviq.<sup>18</sup> Forcat e ushtrisë dhe policisë malazeze të organizuara dhe të furnizuara me artileri filluan ekspeditën ndaj fshatrave të Lugut të Baranit dhe me gjerë. Savë Llazareviqi ishte urdhëruar të fillonte aksionin për mbledhjen e armëve pothuajse nëpër të gjitha fshatrat e Rrafshit të Dukagjinit.

Të gjitha aksionet që bëheshin për mbledhjen e armëve, mbështeteshin fuqishëm në terren nga ushtria dhe xhandarmëria malazeze. Sava kishte marr urdhër nga autoritetet më të larta malazeze, që atyre banorëve që u gjinden armë duhet të pushkatohen, ndërsa ato fshatra që nuk gjinden armë të nxjerrën nga shtëpitë e tyre dhe në prezencën e popit të pagëzoheshin. Ato familje që do kundërshtonin projektet malazeze për asimilimin dhe shtypjen e banorëve shqiptarë në Lugun e Baranit do të pushkatoheshin në prezencën e anëtarëve të familjes. Autoritetet malazeze pasi i mblodhën armët dhe kryen krime ndaj popullatës së pafajshme shqiptare, filluar të marrin masa shumë rigorozë për konvertimin e shqiptarëve katolikë dhe myslimanë në fenë ortodokse.<sup>19</sup>

Sipas burimeve malazeze në 14 fshatrat e Lugut të Baranit janë gjetur armatime të konsiderueshme të fshehura dhe të grupuara nëpër stalla dhe vende tjera të ngjashme. Atyre familjeve që u janë gjetur armët menjëherë është zbatuar urdhri për pushkatimin e tyre. Komandanti Savë Llazareviqi në fshatin Dubovik u ka gjetur banorëve gjashtë (6) pushkë dhe municion të fshehur. Sapo i konfiskuan armët e gjetura banorët u pushkatuan menjëherë në vendin e ngjarjes. Kishte edhe raste kur dhjetë burra (10) që ishin besatuar sipas traditës shqiptare për t'i dorëzuar armët dhe për të shpëtuar familjet e tyre, këta burra u dërguan te rojtari i drejtorisë së qendrës në Lugun e Baranit dhe në përpjekje e sipër për t'u arratisur ata u vranë nga ushtria malazez.<sup>20</sup> Domethënë, autoritetet malazeze duke përdorur të gjitha format antinjerëzore për qëllim e kishin zbatimin e projektit të tyre për asimilimin dhe zhdukjen e popullit shqiptar në Lugun e Baranit dhe në Rrafshin e Dukagjinit.

Savë Llazareviqi në bashkëpunim të ngushtë me Veliko Kapetani i cili ishte i ngarkuar më punë në Gorozhdec, e kishte informuar këtë të fundit se fshatrat e Lugut të Baranit duhej të nënshtroheshin se përndryshe ishte shumë e vështirë zbatimi i projekteve të tyre. Savë Llazareviqi pasi i mori këshillat e Velikos në bashkëpunim më të hartuan planin në Gorozhdec për ndërmarrjen e aksionit për konvertimin e popullsisë së Lugut të Baranit. Sava

<sup>18</sup> Arkivi i Institutit të Historisë-Prishtinë, fondi: Dokumente bullgare 1912.

<sup>19</sup> Zekeria Cana, *Gjenocidi i Malit të Zi mbin popullin shqiptar...*, f. 38, 39.

<sup>20</sup> Arkivi i Institutit të Historisë-Prishtinë, fondi: Državni Arhiv Cerne Gore-DACG-Cetinje, Ministarstvo Imostranih Djela-MID (1913).

e filloi ekspeditën për konvertimin në fshatrat Graboc, Lluzhan dhe Dobërdol, por hasi në rezistencë të fuqishme nga banorët. Forcat e xhandarmerisë malazeze iu hakmerren banorëve të fshatrave në fjalë që e kundërshtuan planin e tyre. Si kundërpërgjigje xhandarmeria malazeze i kishte vrarë rreth dhjetë (10) veta.<sup>21</sup> Ishte një mesazh i qartë edhe për banorët e fshatrave tjera që guxonin të kundërshtonin planin e tyre. Pas masakrave në fshatrat në fjalë, Sava Llazareviqi së bashku më Veliko Kapetanin dhe me bashkëpunëtorë nën përcjelljen e xhandarmerisë malazeze shkuan në fshatin Kryshec në familjen e Selim Gërvallës dhe urdhëruan që të gjithë burrat e fshatit të mblidhen dhe të dorëzohen armët. Shkuarja e Savës në familjen Gërvalla nuk ishte e rastësishme, sepse përmes autoritetit që gëzonte familja Gërvalla u mundua të arrinte qëllimet dhe planet e tij. Fshati Kryshec ishte ndër fshatrat më të mëdha në Lugun e Baranit, ku nënshtrimi dhe dorëzimi i armëve sipas planeve malazeze do të kishte ndikim negativ në aspektin psikologjik të popullsisë e fshatrave tjera në Lugun e Baranit.

Planet malazeze ishin shumë të qarta, sepse, me mbledhjen e armëve do të siguroheshin se nuk do të hasnin në rezistencën e armatosur nga banorët e fshatit Kryshec dhe fshatrave tjera përreth. Autoritete malazeze në krye me Savën vetëm në këtë mënyrë mund t'i realizonin planet e tyre për konvertimin e popullsisë në fshatrat e Lugut të Baranit. Urdhri i Savës ishte i prerë ose duhej të zbatohet deri në fund ose të gjithë do pushkatoheshin. Sava nën kërcënimin e xhandarmerisë malazeze i mblodhi të gjithë burrat e fshatit Kryshec në Kullën Zeqir Kurtëve. Sava u bëri të qartë të gjithë burrave të fshatit pa përjashtim që të dorëzonin armët, por, të vetëdijshëm për pasojat e rënda që i prisnin, në vazhdim kërkesat e Savës u refuzuan nga burrat e fshatit.

Si kundërpërgjigje të refuzimit të kërkesave, Sava urdhëroi të lidhen të gjithë burrat që refuzuan kërkesën e tij. Selim Gërvalla arriti me vonesë në kullën e Kurtëve për të marrë përsipër shpëtimin e burrave të fshatit nga ekzekutimi i xhandarmerisë malazeze. Ardha e Selim Gërvallës u ngjalli shpresë burrave të fshatit dhe kërkoi nga Sava të gjithë burrat të liroheshin, sepse ishin të pafajshëm. Sava e pyeti Selimin se kush jeni ju që mund të më urdhëroni lirimin e tyre, Selimi Gërvalla iu përgjigj me këto fjalë: *“unë jam vëllezër i këtyre burrave që i keni lidhur, ju duhej t'i lironi sepse këta nuk kanë armatim dhe është e padrejtë të torturohen mizorisht dhe të mbahen të lidhur”*. Sava e dinte shumë mirë së Selim Gërvalla e gëzonte përkrahjen e madhe në fshatin e tij Kryshec dhe më gjerë, dhe iu drejtua Selim Gërvallës

<sup>21</sup> Isa Bicaj, *Marrëdhëniet shqiptaro-malazeze...*, f. 185; Isa Bicaj, *Marrëdhëniet shqiptaro-malazeze, 1900-1916* (punim magjistrature), Universiteti i Prishtinës, Fakulteti Filozofik, Departamenti i Historisë, Prishtinë, 1976, f. 86.

më këto fjalë: ju a jeni në gjendje që të garantoni për këta burra të fshatit tuaj që nuk kanë armatim. Selimi pa hezituar fare e mori përsipër përgjegjësinë duke e siguruar Savën se nuk kanë armatim, dhe si rrjedhojë Sava urdhëroi xhandarmerinë që të lirohen të gjithë burrat e fshatit. Sava ishte shumë i qartë dhe i prerë me Selim Gërvallën, duke ia bërë më dije se ke marrë përgjegjësi dhe rrishtë shumë të madh se nëse në fshatin Kryshec do të gjendet armatim, pasojat deri në ekzekutim do t'i bartni ju dhe familja juaj. Selim Gërvalla ishte i vetëdijshëm për veprimet e tij dhe nuk iu frikësua fare fjalëve të Savë Llazareviqit edhe pse e dinte shumë mirë se bashkëfshatarët posedonin armatim. Guximi dhe autoriteti i Selim Gërvallës i bëri shumë përshtypje Savës, duke synuar të përdorte autoritetin e Selimit për të realizuar në mënyrë më të lehtë planet malazeze. Por, në anën tjetër edhe Selim Gërvalla i kishte planet që ta përdorte Savën për shpëtimin e burrave të fshatit nga masakrat malazeze.<sup>22</sup> Selim Gërvalla ishte i vetëdijshëm se një situatë te ngjashme mund të përgatitet shumë më mirë për të shpëtuar banorët e fshatit nga masakrat malazeze.

Duke iu referuar dokumenteve malazeze me rastin e çarmatimit të popullsisë në qytetin e Pejës dhe rrethinës, janë ndërmarrë masat të rrepta dhe të dhunshme, të gjithë të dyshuarit ishin burgosur dhe në saje të përdorimit të torturave çnjerëzore janë zbuluar 50 pushkë të futura në dhe, e për këtë arsye malazetët i pushkatuan (sipas tyre keqbërësit) dhe për këto informacione janë njoftuar rregullisht përmes telegrameve strukturat më të larta të shtetit malazez.

Përmes një komunikate autoritete malazeze njoftuan se janë gjetur shumë armatime të hedhura nëpër rrugët dhe lagjet e qytetit, shihet se tek banorët vazhdon të mbretëron një frikë e madhe dhe si rrjedhojë e saj hidhen të gjitha armët edhe nëpër fshatra dhe rrugëve, nga frika e urdhëresës që kishte dhënë komandant Savë Llazareviqi. Dihet se për këtë çështje sipas këtij urdhri do të ndërmerren të gjitha masat e nevojshme, sepse kjo është mënyra e vetme ndaj atyre të cilët janë duke përgatitur kryengritje. Pra, në luftimin e kësaj dukurie është angazhuar edhe gjykata ushtarake e cila ka dënuar me pushkatim 8 veta që dyshoheshin se ishin përzier në këtë aferë. Për këtë është njoftuar edhe ministri dhe si duket edhe për të, kjo është mënyra më e mirë për të vënë rend dhe qetësi. Nëse vazhdohet me këto masa të detyrimeve dhe torturave do të konvertohen në fenë ortodokse shumë shqiptarë tjerë, sepse

---

<sup>22</sup>ASHAK, Fondi personal i Muharrem Gërvallës nr. 704, shënime për konvertimin e popullsisë shqiptare në fenë ortodokse në Lugun e Baranit në vitin 1913.

vetëm dje janë lajmëruar 20 veta për t'u kryqëzuar, ndërsa dje 4 të kryqëzuar i kanë mbledhur armët e hedhura nëpër rrugë.<sup>23</sup>

Drejtoria Rajonale e Pejës, numër 830, 3 shkurt 1913 në telegramin dërguar ministrit të Punëve të Brendshme të Malit të Zi në Cetinë, z. Plamenko, në lidhje me urdhrin tuaj të sotëm numër 503, me të cilin shkurtohet personeli i kësaj drejtorie, kam nderin t'ju njoftoj që ky vend është i tillë që me një numër të caktuar personeli është e pamundur të kryhet shërbim policor, sepse qyteza e këtushme ka konstruksion të çuditshëm, konstruksioni i saj është i atillë që nuk mund të sqarohet e të përshkruhet. Gati të gjitha shtëpitë kanë oborr dhe shfrytëzohen për fshehjen e keqbërësve, çerdhja e të cilëve gjendet këtu pa e përjashtuar edhe Gjakovën. I gjithë ai popull i ka fshehur armët nën tokë.

Në Pejë dhe rrethinën janë mbledhur më shumë se 8 000 pushkë me fishekë, e po ashtu u gjinden armë dhe municion të fshehura nën tokë edhe pse janë shfrytëzuar masa të rrepta për mbledhjen e tyre. Ata nuk i dorëzuan armët as në mënyrë vullnetare edhe pse ishte kërkuar nga mbreti të kryhet brenda afatit të caktuar në mënyrë që të shpëtojnë nga dënimet. Kjo Drejtori kërkon përforcimin me zyrtarë në marrjen e masave të nevojshme në mbrojtjen e sigurisë dhe pasurisë, andaj propozojmë: 10 masa shtesë, ndër të cilat, 100 xhandarë shtesë ngaqë treqind xhandarët e tjerë dhe komandanti mezi po arrijnë t'i kryejnë detyrat me gjashtë oficerë të xhandarmerisë, ku një pjesë e këtyre xhandarëve të marshojnë pandërprerë nëpër fshatra dhe personat e dyshimtë t'ia dorëzojnë pushtetit që situata të kthehet në rend, të caktohen nga dhjetë agjent-policë të fshehtë për Rajonin e Gjakovës, Pejës dhe të Gucisë në lidhje me gjetjen e armëve të fshehta dhe krimeve të tjera, të caktohen ushtarë për të gjitha këto zona, të caktohet komisioni për zbutjen e konflikteve etj. Në përgjithësi, këtu është e nevojshme që personeli të jetë sa më i përgatitur dhe energjik i cili do të mund t'i kryej detyrat e tij në mënyrë të duhur.<sup>24</sup>

Në telegramin e lëshuar nga organet malazeze në mars të vitit 1913, shkruhet, sot po kthehem nga Peja, çarmatimi në Pejë dhe rrethin e saj po bëhet me shumë vështirësi. Për çdo ditë po grumbullohen dhe po zbulohen armë tek banorët vendas, te disa po gjejmë edhe pushkë të fshehura në tokë, që tri të tilla u gjetën sot. Sipas urdhrin të Komandës së Përgjithshme, armët duhet të dorëzohen ashtu sipas afatit të parashikuar, por nëse nuk ndodh edhe

<sup>23</sup> Arkivi i Institutit të Historisë-Prishtinë, fondi: Državni Arhiv Cerne Gore-DACG-Cetinje, Ministarstvo Imostranih Djela-MID (1913).

<sup>24</sup> Arkivi i Institutit të Historisë-Prishtinë, fondi: Državni Arhiv Cerne Gore-Cetinje-DACG, Ministarstvo Unutrosšnjih Dveta Upravno Odelsnije-MUDUO, (1912-1914).

pas shumë e shumë paralajmërimeve atëherë atyre që u gjenden armët do të kenë pasoja shumë të rënda. Pra, në çdo fshat do të lëvizin patrulla e ushtarëve dhe aty ku hasin në armë do të pushkatohen të gjithë.<sup>25</sup>

Autoritetet malazeze në krye me Savë Llazareviqin pasi e kryen procesin e mbledhjeve të armëve, dhe duke u siguruar se banorët e fshatrave të Lugut të Baranit nuk posedojnë më armë, filluan procesion e konvertimit të popullsisë shqiptare në fenë ortodokse. Religjioni është njëri ndër elementet më të rëndësishme që ka ndikim të drejtpërdrejtë në ndjenjat shpirtërore të shoqërisë njerëzore. Ekspedita e ndërrimit të fesë me anën e forcës dhe pushkatimeve ka vazhduar në pjesën e pushtuar nga Mali i Zi. Por konvertimet më të theksuar ishin në Rrafshit e Dukagjinit veçanërisht në Lugut e Baranit.<sup>26</sup>

Drejtorja Krahinore e Pejës në telegramin dërguar ministrit Plamenac-Cetinë, e lajmëron se tërë komuna do të kalonte në fenë ortodokse. Në mungesë të klerikëve, ju lus që t'i kontaktoni klerikët që gjenden në rrethin e Beranës dhe t'i urdhëroni që të nisën për në Pejë.<sup>27</sup> Në një telegram tjetër lajmëron se masa e madhe e kësaj rrethine që do të kalojë në fenë ortodokse, përveç mungesës së klerikëve mungojnë edhe mësues që duhej t'u shpjegojnë popullit për kombësinë dhe fenë e re që po e përqafojnë. Mungojnë edhe të hollat që janë më se të domosdoshme për zhvillimin e propagandës. Ka edhe mungesë të kopicave malazeze që duhet t'i kenë të kryqëzuarit. Kërkohej që brenda mundësive të dërgohej një numër mësuesish dhe popesh, që të flasin shqip brenda mundësive, të vihej në dispozicion një numër i të hollave, si dhe të dërgoheshin nga Podgorica sasi e madhe kopicash malazeze, të gjitha këto kërkesa janë më se të nevojshme pa të cilat është pothuajse e pamundur për t'i realizuar qëllimet që i kemi para vetës.<sup>28</sup> Në prill të vitit 1913 pjesërisht një pjesë e banorëve të fshatrave të Lugut të Baranit ishin dërguan në Kishën e Pejës përfshirë këtu edhe fëmijët me u pagëzua. Brenda oborrit të Kishës kishte ardhur urdhri nga autoritetet malazeze që burrat shqiptarë t'i heqin kësulatat dhe gratë ta zbulojnë fytyrën. Shqiptarët ishin të shqetësuar se ndërrimi i fesë bëhej pa dëshirën e tyre por ishin të detyruar me dhunë ta bëjnë një gjë të tillë.

<sup>25</sup> Arkivi i Institutit të Historisë-Prishtinë, fondi: Državni Arhiv Cerne Gore-Cetinje DACG, Ministarstvo Imostranij-Djela MID (1913).

<sup>26</sup> Zekeria Cana, Historia nuk shkruhet me kallëzime odash, *Gazeta Bota Sot*, 28, qershor, Prishtinë, 2003, f. 13.

<sup>27</sup> Zekeria Cana, *Gjenocidi i Malit të Zi mbin popullin shqiptar...*, f. 155.

<sup>28</sup> Po aty, f. 157.

Shqiptarëve u mbahej një fjalim nga pop Maksimi ku ndër të tjera thuhej «vëllezër e motra që jeni mbledh në këtë vend me gëzim e zemër po u them dy fjalë, që nga lufta e Kosovës ne jemi nda dhe sot deshi zoti që ne të bashkohemi përsëri dhe mu kthye në fenë e moçme sikur që kanë qenë prindit tonë. Përpara luftës së Kosovës ju të gjithë keni qenë të krishterë por me pushtimin osman populli shqiptarë u islamizua me dhunë, fatkeqësisht duke e përqaftuar fenë islame edhe jeni vra në mes veti pa e ditur se jeni vëllezër. Shumë jam i kënaqur që po ju shoh të mbledhur në oborrin e kësaj kishe që keni shpreh dëshirën me u pagëzua dhe me u kthye në fenë e të parëve.<sup>29</sup> Shamia nuk do të këtë me në këto vende, por të gjithë të bashkuar në një fe, ju me ne dhe na me ju do ta lulëzojmë këtë vend. Ju do të shkolloheni dhe do të keni jetë me të mirë se sa që keni pas përpara. Falënderoj zotin për këtë të mirë që na ka jepe dhe t'i urojmë shëndet e gjitha të mirat Krajl Nikollës».<sup>30</sup>

Drejtoritë krahinore dhe organet policore në raportet e tyre dërguar Ministrisë së Punëve të Brendshme në Cetinë, u shprehën se braktisja e fesë islame dhe përqaftimi i fesë ortodokse bëhej më dëshirë dhe pa presion të shprehur nëpërmjet lutjeve më shkrim. Ndërsa, dokumentet tregojnë të kundërtën për gjendjen e rëndë të një populli të shtypur në mënyrën më të keqe.<sup>31</sup>

Savë Llazareviqi pasi u largua nga fshati Kryshec, i shoqëruar me xhandarmerinë malazeze shkoi në fshatin Vranoc, i cili u prit me shqetësime të mëdha nga banorët. Sava hyri në kullën e Ali Bajraktarit dhe u bëri me dije se Mbreti Nikolla kishte nxjerr urdhrin që e gjithë popullsia e Lugut të Baranit të ndërrojnë fenë meqenëse si vëllezër nuk mund të jetojmë ndarazi. Nën bajrakun e Vranocit ishin rreth 30 fshatra,<sup>32</sup> por, bajraku mbledhej në Kryshec sepse ishte më afër Pejës dhe në rast nevojë të parandalohesh rrezikun që mund t'u vihej.<sup>33</sup> Familja Gërvalla ishin odabash (njeri i mençur dhe besnik që i rinë pranë bajraktarit ose flamurmbajtës) i bajrakut të Vranocit, fakt ky që u ka garantuar atyre pozita më të privilegjuara në Lugun e Baranit.<sup>34</sup> Ali Bajraktari e kërkoi kohën e mjaftueshme për të njoftuar dhe biseduar me banorët e fshatrave për urdhrin që kishte nxjerr Mbreti Nikolla. Pas konsultimeve, banorët e fshatrave të Lugut të Baranit e kundërshtuan urdhrin

<sup>29</sup> Zef Mark Harapi, *Ditt e trishtimit N'Pejë e nder rrethe/1912-1913*, Dukagjini, Pejë, 2004, f. 88, 89.

<sup>30</sup> Po aty, f. 90.

<sup>31</sup> Zekria Cana, Kthimi i shqiptarëve me dhunë në fenë ortodokse më..., f. 23.

<sup>32</sup> Isa Bicaj, *Marrëdhëniet shqiptaro-malazeze...*, f. 186.

<sup>33</sup> Mark Krasniqi, *Lugu i Baranit, Monografi etno-geografike...*, f. 100.

<sup>34</sup> *ASHAK*, Fondi personal Muharrem Gërvalla nr. 704, shënime për konvertimin e popullsisë shqiptare në fenë ortodokse në Lugun e Baranit në vitin 1913.

e mbretit për konvertimin e popullsisë shqiptare në fenë ortodokse. Savë Llazareviqi nuk e priti mirë lajmin i cili urdhëroi xhandarmerinë malazeze që përmes kërcënimeve të armëve të nxjerrë të gjithë banorët e fshatrave të Lugut të Baranit nga shtëpitë e tyre dhe të marshojnë drejt në kishën e Gorozhdecit dhe të Pejës për ta ndërruar fenë.<sup>35</sup>

Pas largimit të Savës për në fshatin Vranoc, Selim Gërvalla filloi me urgjencë të merrte masa mbrojtëse me bashkëfshatarët, sepse e ndjente se shumë shpejt xhandarmëria malazeze do kthehet për ta kontrolluar çdo shtëpi në fshatin e tyre. Selimi në bisedë e sipër me bashkëfshatarët kërkoi prej tyre të mblidhen të gjitha armët dhe të fshehën në xhaminë e fshatit Kryshec. Ideja u mirëprit nga të gjithë banorët pa përjashtim dhe po atë natë armët u dërguan dhe u fshehën në xhaminë e fshatit. Arsyeja pse u fshehën armët në xhami ishte se autoriteteve malazeze nuk do u shkonte mendja për një gjë të tillë, sepse xhamia është vend i lutjeve.

Gjatë grumbullimit të armëve ishte mbushur një qerre kuajsh plotpërplot. Por, fatkeqësisht nuk shkoi kohë e gjatë të nesërmen e lajmëruan Savë Llazareviqin se me rekomandimet e Selim Gërvallës burrat e Kryshecit i kanë mbledhur armët dhe i kanë fshehur në xhaminë e fshatit. Të nesërmen Sava kishte dërguar një korrier në shtëpinë e Selimit për ta lajmëruar që me urgjencë të vijë në stacionin famëkeq të policisë në fshatin Qallapek.<sup>36</sup> Edhe pse situata ishte shumë serioze në familjen Gërvalla, ai nuk u dorëzua përball presionit që i vinte nga autoritetet malazeze. Selim Gërvalla u përgjigjet pozitivisht thirrjes së organeve malazeze. Selimi u përshëndet me familjen dhe i përqafoi dy djemtë e vegjël, Rexhepin dhe Demushin, që i la të mërzhitur dhe në vaj. Ai ishte i bindur se në bazë të rrethanave politike të krijuara në terren do të pushkatohet nga xhandarmëria malazeze sapo të arrinte në stacionin e policisë në Qallapek.<sup>37</sup>

Selim Gërvalla gjatë rrugës për në stacionin e policisë në fshatin Qallapek mendonte si të veprohet për ta kaluar këtë situatë sa me më pakë pasoja. Sapo ishte futur brenda në stacionin, Sava iu drejtua me gjuhë kërcënuese Selimit duke i thënë se me ke garantuar se banorët e fshatit Kryshec nuk posedonin armë, por realiteti ishte krejt tjetër. Selimi nuk ishte shkruar në stacion për t'u nënshtruar urdhrave të Savës, por për të mbrojtur familjen dhe bashkëfshatarët e tij. Selimi pa u trembur fare iu drejtua Savës më fjalët, unë e marrë përgjegjësin për të gjitha veprimet e mia që kanë

<sup>35</sup> Isa Bicaj, *Marrëdhëniet shqiptaro-malazeze...*, f. 186.

<sup>36</sup> *ASHAK*, Fondi personal Muharrem Gërvalla nr. 704, shënime për konvertimin e popullsisë shqiptare në fenë ortodokse në Lugun e Baranit në vitin 1913.

<sup>37</sup> Po aty.

ndodhur në vendlindjen time. Për një moment Sava u shtang nga guximi i Selimit, në heshtje e lëshoi zyrën për t'u konsultuar me bashkëpunëtorët e tij në lidhje me qëndrimet e Selim Gërvallës. Sava pasi u kthye në zyre iu drejtua Selimit më fjalët: *“Je i falur nga Mbreti Nikolla, për këtë të falur ju do t'i prini njerëzve me flamurin malazez në dorë deri në Kishën e Pejës për të ndërruar fenë”*. Selimi Gërvalla i kishte dy mundësi: ose të pranonte propozimin e Savës, ose në të kundërtën do pushkatohet. Selimi e pranoi propozimin për arsye se dëshironte të rezistonte dhe të luftonte së bashku me popullin e Lugut të Baranit. Selimi pasi pranoi propozimin e autoriteteve malazeze këta të fundit u përkujdesen t'ia siguronin uniformën dhe flamurin malazez për t'i prirë kolonës së popullatës për të shkuar në Kishën e Pejës për t'u konvertuar në fenë ortodokse. Banorët në mënyrë të dhunshme përmes kërcënimeve të armëve ishin nxjerrë nga shtëpitë pa kursyer fëmijët, grat dhe pleqtë.<sup>38</sup>

Banorët që kundërshtuan t'iu bashkëngjitën kolonës për ndërrimin e fesë e pësuar edhe me jetë. Në Baran të Epërm brenda ditës u pushkatuan myftiu i fshatit Hazir Alia më të birin Haxhiun, Abdyl Rrustemi, Shyqer Hasani, Abdyl Hasani, Hazir Abdyl, Cubel Zeqiri, Niman Plava, Abaz Jaha, Ali Abazi, Shaban Ademi, Mic Sadiku, Sadri Hasani, ndërsa në Kpuz: vëllezërit Ramë dhe Smajl Meta, Cen Salihu, Abdyl Salihu, Zenun Jusufi, Ymer Zenuni, Rexhep Qerimi dhe Elez Osmani. Në Dobërdol u keqtrajtuat dhe u rrahën të gjithë burrat, kurse Miftar Elezi u masakrua me bajoneta. Në Pejë u vra Sali Bajraktari i Vranocit, Arif Halili nga Poçesta dhe Hamëz Kundra nga Zllapeku.<sup>39</sup>

Gjendja e banorëve ishte tepër e rënduar në aspektin psikologjik, sepse ajo përcillej nga ushtria dhe policia malazeze. Në mënyrën të organizuar autoritetet malazeze urdhëruan banorët të marshonin në drejtim të Kishës së Gorozhdecit dhe të Pejës. Numri i banorëve ishte i madh dhe Kisha e Gorozhdecit nuk kishte kapacitete për të pagëzuar të gjithë në fenë ortodokse. Klerikët ortodoksë rekomanduan që pjesa tjetër e popullsisë në mbikëqyrje shumë rigorozë nga xhandarmëria malazeze të marshojë në drejtim të Patrikanës së Pejës. Selim Gërvalla gjatë rrugës për në Pejë i kishte bërë planet e veta duke u konsultuar më personat më të afërm që i kishte në kolonë, duke u thënë: *“shikoni mundësin dhe bisedoni më njerëz në kolonë nëse mund të bëhemi rreth tridhjetë (30) burra për të kundërshtuar projektet e malazezve, sepse unë sot do e le shpirtin. Selim Gërvalla u kishte bërë me dije bashkëfshatarëve në kolonë se unë i gjallë fenë nuk ka kush që na ndërron*

<sup>38</sup> Po aty.

<sup>39</sup> Zekria Cana, *Kthimi i shqiptarëve me dhunë në fenë ortodokse më 1912-1913...*, f. 23.

*dhe do ta marrin vesh shumë shpejt së kush është Selim Gërvalla*". Pasi u konsultuan burrat në kolonë, e lajmëruan Selim Gërvallën se të gjithë ishin në gjendje të sakrifikonin për të kundërshtuar me çdo kusht projektet malazeze për ndërrimin e fesë.<sup>40</sup>

Gjatë rrugës për në Kishën e Pejës popullsia shqiptare nuk ishin rrahur, por ishin kërcënuar që të jenë më të dëgjueshëm. Sapo arriti kolona në hyrje të qytetit të Pejës të Ura e Gurit një qytetar i njohur me emrin Ristë Bojaxhija, nga pragu i dyqanit të tij e provokon Selim Gërvallen duke i thënë "për hajr të qoftë feja e moçme". Selim Gërvalla, Riston e kishte njohur kohë më parë madje edhe e kishte ndihmuar materialisht në disa raste. Selim Gërvalla zemërohet së tepërmi i prirë edhe nga ndjenjat kombëtare ku priste momentin e caktuar për të thyer flamurin malazez. Selimi i zemëruar e hoqi kapelën malazeze nga koka dhe e hodhi, e theu shtizën e flamurit malazez, e grisi dhe e shqelmojë për tokë.<sup>41</sup> Pastaj Selim Gërvalla u drejtohet kolonës me

<sup>40</sup> ASHAK, Fondi personal Muharrem Gërvalla nr. 704, shënime për konvertimin e popullsisë shqiptare në fenë ortodokse në Lugun e Baranit në vitin 1913.

<sup>41</sup> ASHAK, Fondi personal Muharrem Gërvalla nr. 704, shënime për konvertimin e popullsisë shqiptare në fenë ortodokse në Lugun e Baranit në vitin 1913: Isa Bicaj, *Marrëdhëniet shqiptaro-malazeze (1881-1914)*, Instituti i Historisë, Prishtinë, 2003, f. 186; Isa Bicaj, *Marrëdhëniet shqiptaro-malazeze 1900-1916* (punim magjistrature), Universiteti i Prishtinës, Fakulteti Filozofik, Departamenti i Historisë, Prishtinë, 1976, f. 86; Isa Bicaj, *Marrëdhëniet shqiptare-malazeze në fund të shek. XIX dhe në fillim të shek. XX* (Disertacion), Republika e Shqipërisë, Akademia e Shkencave, Instituti i Historisë, Tiranë 1998, f. 139, 142; Kohën e fundit kanë filluar të shkruajnë rreth thyerjes së flamurit malazez njerëz që nuk janë të fushës dhe që nuk e njohin fare historinë e kësaj ngjarjeje. Studiuesi Isa Bicaj është njëri ndër njohësit më të mirë të marrëdhënieve shqiptaro-malazeze. Gjatë hulumtimeve në terren në vitin 1974 për të përgatitur punimin e magjistraturës, më vonë edhe të doktoratës, dëshmon me argumente rreth thyerjes së flamurit malazez. Në librin e tij *Marrëdhëniet shqiptaro malazeze, 1845-1912*, botuar nga Instituti i Historisë, Prishtinë 2003, e shpjegon në mënyrë të argumentuar thyerjen e flamurit malazez nga Selim (Ahmet) Gërvalla. Gjatë punës në terren në tetor të vitin 1974, profesor Bicaj kishte intervistuar njerëz të shquar në Lugun e Baranit në lidhje me thyerjen e flamurit malazez. Ndër njerëzit më të mençur të kësaj treve ishte padyshim Zekë Jusuf Gërvalla, plak në moshën 83-vjeçar. Zekë Gërvalla në vitin 1913 kur është thyer flamuri malazez ishte në moshën 22-vjeçare, dhe shumë mirë e mbante mend ngjarjen që kishte ndodhur në Pejë. Në tetor të vitit 1974 në intervistën e tij dhënë profesor Bicajt, Zekë Jusuf Gërvalla në mënyrë objektive tregon ngjarjen dhe thyerjen e flamurit malazez nga Selim (Ahmet) Gërvalla. Zekë Jusuf Gërvalla përveç së ishte dëshmitar i ngjarjeve që kishin ndodhur në vitin 1913 në Lugun e Baranit, por edhe u rrit me lavdin e ngjarjes në fjalë, sepse kjo ngjarje ishte pjesë e pandashme e diskutimeve nëpër odat e Rrafshit të Dukagjinit. Profesor Isa Bicaj, për ta argumentuar sa më fuqishëm thyerjen e flamurit malazez, kishte vajtur edhe në Vranoc në Kullën e Bajraktarëve, për të marrë versionin e tyre rreth thyerjes së flamurit malazez në vitin 1913. Po ashtu në tetor të vitit 1974, profesor Bicaj e kishte marrë në intervistë Musli Bajraktarin plak në moshën 72-

tone të larta, duke u thënë: “çoni gishtat duke u bërë thirrje për rezistencë”. Masa menjëherë filloi përplasjet më ushtrinë dhe policinë malazeze.<sup>42</sup>

Pas veprimit të Selimit forcat malazeze filluan të keqtrajtonin popullatën shqiptare. Ushtria malazeze e ndan kolonën e popullsisë në dy pjesë, në njërën anë burrat dhe në anën tjetër gra dhe fëmijë. Një pjesë e popullsisë duke e shfrytëzuar rrëmujën e krijuar kishte arritur të largohet nga vendi i ngjarjes duke i shpëtuar konvertimit në fenë ortodokse. Ushtria dhe policia malazeze arrestuan shumë burra në mesin e tyre edhe Selimin dhe i dërgojnë në burgun e Pejës. Aty u torturuan në mënyrë mizore deri në vdekje, për të vërtetuar se a janë gjallë ende të burgosurit e alivanosur, ushtria dhe policia malazeze ua shtypnin gishtat e dorës me gur, ata që i kishin mbijetuar torturave merreshin gjatë natës dhe i dërgoni për pushkatim te Varret e Gjata në dalje të Pejës.

Dëshmitarët që kishin shpëtuar kanë rrëfyer se malazezët kishin menduar se Selim Gërvalla kishte vdekur nga torturat e marra. Pasi Selimit i kthehet vetëdija dhe i dëgjon britmat e shokëve, u thërret shokëve “*qëndroni burra*”, e ata kur e panë se Selimi ishte akoma gjallë, vendosen me e marrë dhe me dërgua për pushkatim. Por, Selimi fal vigjilencës arriti t’i ikë pushkatimit duke u fshehur, dhe pastaj largohet për në Prizren në shtëpinë e Ukë Peshkut ku edhe u shërua nga plagët e marra.<sup>43</sup> Policia malazeze në mënyrë të vazhdueshme e kërkonte Selimin, por kur ndryshuan rrethanat politike dhe u qetësua gjendja, Selimi kthehet në familjen e tij, për të vdekur pas gjashtë vjetësh.

Falë presionit ndërkombëtar dhe veçanërisht të Austro-Hungarisë, Mbreti i Mali i Zi Nikolla, u detyruar të ndalonte politiken gjenocidale ndaj popullit shqiptar në Rrafshin e Dukagjinit. Austro-Hungaria e përkrahte fuqishëm çështjen shqiptare dhe ishte e vendosur që më çdo kusht të frenonte fuqizimin e një fuqie pushtuese siç pretendonte Serbia dhe Mali i Zi të zëvendësonte Portën e Lartë në trevat shqiptare.<sup>44</sup> Mali i Zi nuk ishte i

---

vjeçare. Profesor Bicaç pasi e hapi diskutimin lidhur më thyerjen e flamurit malazez, kërkoi që në mënyrë sa më objektive të dëgjojë të vërtetën e kësaj ngjarjeje. Pasi diskutuan gjerë e gjatë për ngjarjen në fjalë, shumë të rëndësishme për rajonin e Lugut të Baranit dhe më gjerë, Musli Bajraktari iu drejtua profesorit Bicaç më këto fjalë: “*Ashtu siç të ka treguar Zekë Jusuf Gërvalla ngjarjen për thyerjen e flamurit malazez nga Selim Ahmet Gërvalla në vitin 1913 është e vërtetë*”.

<sup>42</sup> Po aty.

<sup>43</sup> *ASHAK*, Fondi personal Muharrem Gërvalla nr. 704, shënime për konvertimin e popullsisë shqiptare në fenë ortodokse në Lugun e Baranit në vitin 1913.

<sup>44</sup> Miranda Vickers, *Midis serbëve dhe shqiptarëve, një histori e Kosovës*, Botime Toena, Tiranë, 2004, f. 111.

gatshëm të fillonte luftën kundër Austro-Hungarisë, sepse kjo e fundit e kishte mbështetjen e Gjermanisë. Mbreti Nikolla pasi e analizoi mirë gjendjen e krijuar në terren u detyrua të ndalte masakrat dhe pretendimet territoriale në dëm të tokave shqiptare.<sup>45</sup> Krimet malazeze ndaj popullit shqiptar në Rugovë, Pejë, Lugu i Baranit, Deçan dhe Gjakovë do ishin akoma edhe më të mëdha sikur mos të ndërhynte faktori ndërkombëtar në krye me Austro-Hangarin.

Familja Gërvalla ka dhënë kontribut të çmuar për çlirimin e Kosovës që nga Lidhja Shqiptare e Prizrenit e deri të lufta e fundit në Kosovës. Serbia dhe Mali i Zi edhe në periudhën ndërmjet dy luftërave botërore (1918-1941) e vazhduan politikën kundër popullit shqiptar të Kosovës përmes reformës agrare. Njëra ndër qëllimet kryesore të reformës agrare ishte kalimi nga feudalizmi në kapitalizëm. Por, në fakt autoritete serbo-malazeze përmes reformës agrare synonin ndërrimin e hartës demografike të Kosovës, spastrimin etnik të shqiptarëve të Kosovës etj. Autoritete serbo-malazeze duke u thirrur në reformën agrare e goditën familjen e Selim Gërvallës duke u marr tokat. Familja Gërvalla e kundërshtoi reformën agrare, por ishte e pafuqishme që të ndalonte një gjë të tillë. Familja Gërvalla edhe gjatë aksionit të mbledhjes së armëve në Rrafshin e Dukagjinit gjatë viteve 1955/56 ishte torturuar dhe rrahur nga regjimi serb. Edhe në proceset e tjera historike siç ishin demonstratat e vitin 1968 dhe 1981, familja Gërvalla e mbështeti fuqishëm organizimin e tyre.

Familja Gërvalla ka dhënë kontribut të çmuar për çlirimin e Kosovës edhe në luftën e lavdishme të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, 1998-1999. Brezi i tretë, stërnipat e Selim Gërvallës, vëllezërit: Gani Gërvalla, Haki Gërvalla dhe Besim Gërvalla që jetonin dhe vepronin në fshatin Kryshec me shpërthimin e luftës në Kosovë iu bashkëngjiten radhëve të UÇK-së. Me formimin e shtabit ushtarak në Kryshec, Haki Gërvalla ishte zgjedhur zëvendëskomandant. Më 29 maj 1998 në orët e hershme të mëngjesit forca të shumta të ushtrisë dhe policisë serbe kishin filluar ofensivën ushtarake në Lugu e Barani. Ushtria serbe sapo ishte pozicionuar te vendi i quajtur Përroi i Gërvallës sulmojnë fuqishëm me granata në drejtim të lagjes “Gërvalla”. Marshimi i ushtrisë serbe vazhdoi deri në fshatin Vranoc duke garantuar nga të gjitha anët fshatrat e Lugut të Baranit. Lagja “Gërvalla” nën komandën e Haki Gërvallës u mobilizuar brenda mundësive për ta ndalur hovin e ushtrisë serbe. Njësitet e UÇK-së gjatë asaj kohe kishin mungesë të madhe të armatimit, posedonin rreth dhjetë (10) armë dhe pak municion. Në mungesë të armëve dhjetë ose më shumë persona e përdornin një armë duke u ndërruar me njëri-tjetrin. Pastaj në ndihmë u kishin ardhur edhe forca nga fshatrat

<sup>45</sup> Isa Bicaj, *Marrëdhëniet shqiptaro-malazeze...*, f. 167.

përreth duke e ndalur hovin e ushtrisë serbe. Luftimet zgjatën deri në orët e mbrëmjes. Ndërsa, Agim Gërvalla vëllai i Ganiut, Hakiut dhe Besimit që vepronte në Aarau të Zvicrës kishte dhënë kontribut të madh për armatosjen e fshatrave në Lugun e Baranit. Agim Gërvalla ishte zgjedhur kryetar i shoqatës humanitare "Krysheci" me seli në Aarau të Zvicrës. Shoqata kishte numër të madh të anëtarëve dhe falë kontributit të tyre kishin arritur të mbledhnin rreth 300 mijë franga zvicerane për blerjen e armëve në Shqipëri. Agim Gërvalla e kishte marrë përsipër dhe kishte vajtur katër herë në Tropojë për t'i koordinuar punët rreth blerjes së armëve. Herën e fundit Agim Gërvalla në Tropojë ishte takuar me Agim Ramadanin dhe Rustem Berishën, të cilët ia kishin nënshkruar dokumentacionin për armatosjen e fshatrave Kryshec, Dubovikë, Prapaqan dhe Broliq. Gjatë asaj kohë ishte shumë sfiduese koordinimi për blerjen e armëve në Tropojë për arsye nga më të ndryshmet. Por, falë vigjilencës dhe guximit, Agim Gërvalla kishte arritur që të dërgonte deri në fund misionin e tij për armatosjen e fshatrave në Lugun e Baranit.

Vëllezërit Islam, Agron, Bujar, Nuredin, dhe Haradin Gërvalla po ashtu iu bashkëngjitën radhëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Islam Gërvalla kishte vajtur në Shqipëri për armatim, ku mori pjesë edhe në betejën e Loxhës dhe Junikut. Bujar Gërvalla mori pjesë në betejën kundër ushtrisë serbe për mbrojtjen e lagjes "Gërvalla". Ndërsa Agron Gërvalla dhe Nuredin Gërvalla më 7 prill 1998, u kthyen nga Zvicra dhe iu bashkuan radhëve të UÇK-së. Nuredini fillimisht luftoi në Zonën Operative të Drenicës ku mori pjesë në shumë beteja, si: beteja e Llapushnikut, Likocit, Zatriqit. Nuredin Gërvalla pastaj u transferua në Zonën Operative të Dukagjinit. Nuredini mori pjesë në betejën e Gllogjanit, Ratishit Jabllanicës etj. Gjatë bartjeve të ushtarëve të plagosur të UÇK-së për në Shqipëri, Nuredin Gërvalla më 24 maj 1999, në Bogiqe në trekëndëshin e kufirit Shqipëri-Kosovë-Mali i Zi bie heroikisht në fushën e betejës. Agron Gërvalla ishte veprimtar i dalluar i Lëvizjes Popullore të Kosovës (LPK), i cili dha kontribut të çmuar për çështjen kombëtare. Po ashtu Agroni dha kontribut të madh si anëtar i logjistikës së UÇK-së në Evropë e deri në SHBA. Haradin Gërvalla pas ofensivës së shtatorit të vitit 1998 ka marrë pjesë në betejën e Kralanit, Prilepit, Pozharit etj.

Vëllezërit Xhafer, Demush dhe Sefadin Gërvalla iu bashkëngjitën radhëve të UÇK-së. Xhaferi dhe Demushi morën pjesë në betejën kundër ushtrisë serbe për mbrojtjen e lagjes "Gërvalla". Gjatë luftimeve në radhën e njësiteve të UÇK-së ishte plagosur Demush Gërvalla. Sefadin Gërvalla përveç betejës në lagjen "Gërvalla" mori pjesë edhe në betejën e Loxhës dhe Junikut.

Krimet e ushtrisë dhe policisë malazeze në rrafshin e Dukagjinit dhe veçanërisht në Lugun e Baranit ishin shumë të rënda. Ushtria malazeze përdori mënyrat më çnjerëzore ndaj shqiptarëve të pafajshëm që jetonin në tokat e tyre stërgjyshore. Shqiptarët asnjëherë nuk iu nënshtroar pushtetit malazez pa marrë parasysh persekutimet që iu bënë në vazhdimësi.

Luan TETAJ

## SUMMARY

### **MONTENEGRINE CRIMES IN THE BARAN VALLEY AND THE BREAKING OF THE MONTENEGRO FLAG BY SELIM (AHMET) GARVALLA IN 1913**

The Montenegrin crimes against the Albanians in the Dukagjin Plain and especially in the Lugu Baran is also reflected in the Montenegrin documents, which provide detailed information on the commission of crimes against the innocent and unprotected Albanian population who lived in their native lands. The Montenegrins, in order to completely subjugate the Lugu Baran, began the action to collect weapons, which was also accompanied by mass killings. Sava Lazarevic, commander of the gendarmerie in Peja, was given the order to start the action to collect weapons in almost all the villages of the Dukagjin Plain, each time relying on the help of the Montenegrin army and police.

The king of Montenegro had given an order that the inhabitants of the villages should convert to the Orthodox religion or else they would be punished, those who dared to oppose this order were cruelly mistreated by the Montenegrin forces. The population of Baran Valley was violently gathered by the Montenegrin forces to be sent to the Church of Peja without excluding children, women and the elderly to change their religion and be baptized. According to the authorities, Lugu i Barani had to be subdued, otherwise it was very difficult to achieve their goals. The Montenegrins presented the army uniform and the Montenegrin flag to Selim Gërvalla in order for him to lead the population. At the entrance to the city of Peja, Selim Gërvalla broke and tore the Montenegrin flag and kicked it to the ground. The Montenegrin genocide against the Albanians in the Lugu Baran was very brutal, different methods were used there, violence, shootings, massacres, etc.